

URDHËR
Nr. 29, datë 17.3.2014

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 620, DATË 22.11.2012 “PËR MIRATIMIN E LLOJEVE
TË DEKLARATËS SË INTERESAVE PRIVATË”**

Në zbatim të nenit 15 germa “a”, të nenit 40 pika 1 germa “d” dhe nenit 21 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, dhe në rregulloren e brendshme të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave,

Me arsyetimin se:

Me urdhrin nr. 620, datë 22.11.2012 të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKP-së “Për miratimin e llojeve të deklaratës së interesave privatë”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 154 të vitit 2012, janë miratuar format e deklaratës së interesave privatë, “Para fillimit të detyrës”, “Periodik/vjetor”, “Pas largimit nga detyra” dhe “Me kërkesë”;

Në faqen 12 të formularëve sipas modelit të miratuar, është përcaktuar dhe mënyra e plotësimit të tyre, me shkrim dore ose në mënyrë elektronike;

Nisur nga fakti se formulari i deklarimit konsiderohet dokument zyrtar dhe duhet të përmbajë të gjithë elementet e një dokumenti zyrtar, duhet të shmanget plotësimi me shkrim dore, duke paraqitur saktësi, seriozitet dhe estetikë,

URDHËROJ:

Në faqen nr. 12 të deklaratës private para fillimit të detyrës, deklaratës së interesave privatë periodik/vjetor dhe deklaratës së interesave privatë pas largimit nga funksioni, bëhet ndryshimi si vijon:

Fjalja “Formulari i deklarimit të plotësohet me shkrim dore ose në mënyrë elektronike, por në çdo rast nënshkruhet me shkrim”, zëvendësohet me fjalinë: “Formulari i deklarimit plotësohet vetëm në mënyrë elektronike (me kompjuter)”. Pas printimit të formularit të plotësuar sipas kërkesave ligjore, bëhet nënshkrimi për çdo fletë të tij, sipas rubrikave përkatëse.

Zyrtari plotëson dhe nënshkruan dokumentin nga faqja 1 deri në faqen 7 të tij.

Personi i lidhur (bashkëshorti/ja dhe fëmijët madhorë) plotëson dhe nënshkruan, në rastet si vijon:

a) Kur kanë pasuri të regjistruar veçmas në emër të tyre, plotësojnë në mënyrë elektronike vetëm me kompjuter faqen 7-11;

b) Kur nuk kanë pasuri të regjistruar veçmas në emër të tyre, plotësojnë vetëm faqen nr. 8.

2. Dorëzimi i deklaratës nga zyrtari do të bëhet vetëm në zyrën e autoritetit përgjegjës të institucionit publik ku punon.

3. Bazuar në shkronjën “e”, neni 40 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, mosplotësimi në mënyrë elektronike dhe me kompjuter i deklaratës së interesave privatë para fillimit të punës, deklaratës së interesave privatë periodik/vjetor dhe deklarata e interesave privatë pas largimit nga funksioni, përbën shkelje ligjore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM
Shkëlqim Ganaj

KËRKESË

Shtetasi Tahsim Banushaj, i datëlindjes më 25.11.1951, lindur dhe banues në Vlorë, kërkon pranë Gjykatës

së Rrethit Gjyqësor Vlorë shpalljen të vdekur të vëllait të tij, shtetasit Astrit Banushaj.

KËRKUESI
Tahsim Banushaj

KËRKESE

Shtetësja Shpresa Musaj, e datëlindjes 25.4.1940, lindur në Selenicë dhe banuese në Tiranë, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan shpalljen të vdekur të bashkëshortit të saj, shtetasit Bardhyl Musaj.

KËRKUESE
Shpresa Musaj